



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT  
KËSHILLI I BASENIT UJOR "VJOSË"**

*Pv 575 Prot  
dt 23.04.2018*

**VENDIM**

Nr. 1 \_ Data 05.04.2018 \_

**Për miratimin e lejes së ujit , për ambalazhim në shishe ose në enë, burimit uJOR Nr 5, fshati Tragjas, Njësia Administrative Orikum, Bashkia Vlorë, Qarku Vlorë, subjektit "Joana Tragos" Sh.P.K., me administrator Z. Tonin Troqe**

Në bazë të ligjit **Nr.111/2012 datë 15.11.2012** "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të **V.K.M 416 datë 13.05.2015** "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", Formulari A/2 "Kërkesë për ujë për ambalazhim në shishe ose enë", Vendimit **Nr. 876, datë 14.12.2016** "Për miratimin e tarifave të shpenzimeve administrative" si dhe Vendimit **Nr. 662 datë 21.09.2016** "Miratimin e tarifave të përdorimit të ujit dhe të shkarkimeve të lëngëta ",Vendimit **Nr.5 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit UJOR", Vendimit **Nr.6 datë 16.02.2016**, Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjensisë së Basenit UJOR";

**VENDOSI**

Miratimin e lejes së ujit , për ambalazhim në shishe ose në enë, burimit uJOR Nr 5, fshati Tragjas, Njësia Administrative Orikum, Bashkia Vlorë, Qarku Vlorë, subjektit "Joana Tragos" Sh.P.K., me administrator Z. Tonin Troqe me këto të dhëna;

Koordinatat: X 4466729.7; Y 4373426.46; Z 16.165

Prurja mesatare : 6.5 l/sek

Prurja minimale: 6 l/sek

Sasia e ujit që do të përdoret 5 l/s

Afati i lejes 5 vjet

Për përdorimin e këtij burimi ujor duhen të plotësohen me përpikmëri kushtet e lejes.

Ngarkohet ABU për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR I K.B.U “VJOSË”**

**Flamur MAMAJ**

**PËRGJEGJËS I A.B.U “VJOSË”**

**Hir PROFKA**

